

Projekti

Aksionet e Komunitetit per Zonat e Mbrojtura

Guida

Thirrje Shkollave për Veprim

Programi i Minigranteve

[AID No. 011521 / Celim / Alb]

Afati I dorezimit te aplikimeve per fazen e pare eshte data 10/02/2019

Vlorë

Janar 2019

Thirrje Shkollave Për Fonde Veprimi CSAF	
Objektivi i Fondit	Rritja e ndërgjegjësimit dhe sensibilizimit mbi çështjet mjedisore duke përfshirë komunitetin lokal nëpërmjet një programi të edukimit mjedisor dedikuar shkollave, që konsiston në realizimin e aktiviteteve dhe veprimeve në brendësi të zonave të mbrojtura.
Shkollat	Shkollat duhet të jenë të vendosura afër zonave të mbrojtura dhe në brendësi të bashkisë së referuar: • <u>Parku Kombëtar Llogara</u>: Bashkia e Vlorës • <u>Peisazhi i Mbrojtur Vjosë-Nartë</u>: Bashkia e Vlorës • <u>Parku Kombëtar “Bredhi i Hotovës”</u>: Bashkia e Përmetit dhe Këlcyrës • <u>Parku Kombëtar “Mali i Tomorrit”</u>: Bashkia e Beratit, Skrapardhe Policanit Shkollat e sistemit parauniversitar, të ciklit të parë (6 -15 vjec) ose me te larte (15-19 vjec) do të marrin një informacion specifik mbi çështjet mjedisore, me fokus zonat e mbrojtura, me përgjegjës mësuesët me të cilët rregullohet një program i takimeve informative duke u bazuar në moshën e nxënësve. Programi i trajnimit përfshin një minimum prej 12 vizitash ndërgjegjëse në Zonat e Mbrojtura për t'u konsideruar si një mjet përgatitor për konceptimin dhe zbatimin e mëvonshëm të veprimeve dhe ndërhyrjeve në këto zona nga mësuesët dhe nxënësit. Administratat Rajonale të Zonave të Mbrojtura do të jenë të përfshira në të gjitha aktivitetet e përshkruara mësipër, si në ideime dhe në realizimin e veprimeve që programi i minigranteve “Thirrje Shkollave për veprimi” do të financojë.

**Qellimi i projekt
propozimeve per
perfitimin e
minigranteve**

Qellim i projekteve me keto grante do te jete zhvillimi i aktiviteteve me karakter mjedisor, masa per mbrojtjen e tij duke arritur objektiva te qarta per venien ne zbatim te parimeve te edukimit mjedisor ne shkolla. Drejtimet kryesore per projektet mund te jene (por jo vetem) ne kategorite :

Per tu ardhur ne ndihme mesuesve eshte pergatitur nje liste me tematika projektesh:

- Panairë me rastin e diteve te shenuara mjedisore me aktivite dhe informim të komunitetit të shkollës dhe prinderve për mbrojtjen dhe respektimin e mjedisit. dhe ndërgjegjësimin mbi temën e riciklimit. Realizojne punime artistike kushtuar natyres vizatime, këngë, poema dhe shumë veprime të tjera.
- Hartojnë dhe zhvillojnë një fushatë ndërgjegjësimi që promovon natyrën shqiptare. Për të promovuar ruajtjen e natyrës pastrojnë zonat e gjelbra rreth shtëpive dhe shkollës së tyre dhe mbjellin pemë. Ndërgjegjësojnë komunitetin për mos dëmtimin dhe zhdukjen e mjediseve të gjelbërta apo pyjeve përmes fushatës ndërgjegjëse, vendosjes së tabelave paralajmëruese dhe sensibilizuese.
- Ruajtja e energjisë përmes vendosjes së llambave ekonomike dhe shfrytëzimit efektiv të tyre. Zëvendësimi i llampave halogjene me llampa që kursejnë energjinë, vendosja e çezmave të ujit me sensorë etj
- Organizimi i një teatri apo drame në shkollë për të informuar shokët dhe familjet për rëndësinë e një çështjeje të caktuar mjedisore
- Ndermarrin aksione per mbjelljen e pemeve ne zonat e mbrojtura po ne ambientet e oborrit apo koshtit te shkolles
- Ndertojne ne Shkolle këndin e “Natyralistëve të vegjël” apo kendin “Njeriu dhe mjedisi”, duke pergatirur postera dhe punime artisitke te nxensve qe japin mesazhe per mbrojtjen e Mjedisit. Përdorin materiale të riciklueshme për të ilustruar modele të ndryshme ekosistemesh. Krijojnë një pemë biodiversiteti që ilustron larminë e gjallesave në natyrën shqiptare duke e vendosur në një kënd të dukshëm në shkollë .
- Ndertojme kopshtin e gjelber ne tracen /veranden apo oborrin e shkolles.
- “Ne nuk jetojmë vetëm” Fëmijët dhe mësueset evidentojnë bimët dhe kafshët e zones së tyre, rërndësinë e tyre, nëse ka ndonjë prej tyre që është e rrezikuar. Cilat mund të jenë veprimet që mund të ndërmerren për mbrojtjen e tyre, aktivite ndërgjegjesuese me komunitetin. Fëmijët mund të bëjnë edhe tabela ekologjike për evidentuar këtë bimë e kafshë. Kjo është ideale për shkollat q endëdhen në zona të

	mbrojtura apo pranë parqeve kombëtare. Formati i aplikimit ndodhet prane INCA www.inca-al.org. Per vitin academic 2018-2019 do te publikohen dy thirrje per propozime, e para nga 15 dhe afati i dorezimit do te jete data 10 Shkurt 2019. Thirrja e dyte pritet te publikohet ne mes te muajit Mars 2019. Cdo propozim i paraqitur ndryshe nga modeli i miratuar dhe i paraqitur jashte afatit te lartpermendur refuzohet me shkrim nga ana e Menaxherit te Programit te Minigranteve (INCA). Per vleresimin e propozimeve ngrihet Komisioni i Vleresimeve te Projekteve. Seleksionimi paraprak mbeshetet ne listen prioritare te miratuar, modelin e projektit, buxhetet e propozuar dhe afatet e dorezimit te projekt propozimeve.
Tipet e Investimeve te lejuara dhe kostot e pranueshme	Pritet të financohen 3 tipe të investimeve te lejuara: ➤ <i>Veprimtari të realizueshme brenda ambienteve tëshkollës</i> Në veçanti, për shkollat që janë të vendosura në qendrat kryesore urbane, do të jetë e mundur të financohen ndërhyrjet që parashikojnë krijimin e laboratorëve ose elemente të tilla si kopshte perimesh, serra, mbjellja e pemëve në oborre etj. ➤ <i>Veprimtari të realizueshme brenda Zonave të Mbrojtura</i> Në veçanti, për shkollat që ndodhen pranë Zonave të Mbrojtura dhe u kërkohet autorizim nga autoritetet kompetente, do të jetë e mundur të financohen ndërhyrjet për krijimin e klasave të jashtme të dedikuara për studimin specifik të disa llojeve shtazore (shpendët, peshqit, etj.) ose elementëve natyrorë (dunat, pyjet etj.) ➤ <i>Veprimtari ndërgjegjësuere mbiçështjet mjedisore</i> Per fushata ndërgjegjesuese lokale apo kendet/klubet mjedisore te shkollave do te jete e mundur financimi i paisjve te nevojshme dhe te justifikuara ne funksion te fushates Pjesa më e madhe e kostove të pranueshme duhet të jenë për

	materialet dhe pajisjet arsimore që do të përdoren për aktivitetet e edukimit mjedisor. Propozimet që përfshijnë fonde për objekte, mallra dhe shërbime që i nevojiten shkollës për realizimin e aktivitetit të edukimit mjedisor do të vlerësohen si të pranueshme. Kostot e rikonstruksionit nuk mund të kalojnë 20% të buxhetit të përgjithshëm dhe duhet të synojnë riparimin e mjedisve arsimor për qëllime mjedisore, kostot e transportit nuk mund të kalojnë 20% dhe duhet të synojnë transportin në zonat e mbrojtura për të kryer aktivitetet e edukimit mjedisor.
Vlera e Fondit në total	48.000 Euro
Periudha e Implementimit të programit të Minigranteve	Janar 2019 – Mars 2021
Limiti i Minigranteve	Propozimet financiare për minigrantet duhet të jenë minimumi 1.000 Euro dhe maksimumi 3.000 Euro
Kriteret e seleksionimit të projekt-propozimit	⇒ cilësia e projektit në përgjithësi dhe arsyetimi i tij; 10 pike ⇒ pajtueshmëria e projektit të hartuar dhe edukimi mjedisor në shkollë; 15 pike ⇒ objektivat kryesore të projektit dhe pajtueshmëria e tyre me prioritetet e përcaktuara në thirrje; 10 pike ⇒ evidentimi i rrugëve dhe mjeteve për arritjen e objektivat të projektit dhe të mundësive përkatëse të realizimit të tij; 20 pike ⇒ ndikimi dhe efektet e rezultateve të pritshme; 20 pike ⇒ alternativat për arritjen e rezultateve. 15 pike

	⇒ Buxhet efektiv dhe i justifikuar 10 pike
--	--